

VENDIM
Nr. 512, datë 17.7.2019

PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË MJEKIMIT TË Z. VLADIMIR GROSHA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, dhe të vendimit nr. 46, datë 30.1.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2019”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Mbulimin e shpenzimeve të mjekimit të z. Vladimir Grosha, në masën 1 300 000 (një milion e treqind mijë) lekë.
2. Ky fond të përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor.
3. Pagesa të bëhet me paraqitjen e faturave përkatëse të institucionit të kurimit.
4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTËR
Edi Rama